

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR RINOVIMIN E NDËRTESAVE”

I. QËLLIMI I PROJEKT-VENDIMIN DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt-vendim synon miratimin e Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave, si një mjet strategjik dhe operacional për mobilizimin e investimeve në sektorin e ndërtesave, përmes ndërhyrjeve të thella në stokun ekzistues rezidencial, publik dhe atë të shërbimeve, me qëllim të:

- a) Promovimit dhe përmirësimit të performancës energjetike të ndërtesave;
- b) Reduktimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;
- c) Transformimit të stokut ekzistues të ndërtesave në ndërtesa pa emetime deri në vitin 2050;
- ç) Reduktimit të varfërisë energjetike.

II. VLERËSIMI I PROJEKT VENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projekt vendim është në përputhje të nenit 100 të Kushtetutës, Nenit 5 të Ligjit Nr. 37/2025 “Për performancën energjetike të ndërtesave”, Strategjinë Aftagjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT VENDIMIT ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë:

1. **Reduktimi i konsumit dhe kostove të energjisë:** Masat e rinovimit të thelluar të ndërtesave do të kontribuojnë në uljen e ndjeshme të konsumit të energjisë elektrike dhe termike, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e shpenzimeve për familjet, bizneset dhe institucionet publike.
2. **Përmirësimi i kushteve të jetesës:** Investimet në përmirësimin e izolimit termik, sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit përkthehen në më shumë komfort termik, përmirësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm dhe shëndet më të mirë për banorët.
3. **Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë:** Plani kontribuon në arritjen e objektivit të dekarbonizimit të sektorit të ndërtesave deri në vitin 2050, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit dhe angazhimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.
4. **Nxitja e ekonomisë dhe punësimit:** Implementimi i masave të rinovimit do të gjenerojë kërkesë për fuqi punëtore në ndërtim, energji, projektim dhe sektorë të tjerë mbështetës, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Problematikat:

5. **Financimi i projekteve të rinovimit:** Një nga sfidat kryesore është sigurimi i burimeve financiare për zbatimin e masave të rinovimit, veçanërisht për familjet, institucionet dhe sektorin e shërbimeve me të ardhura të kufizuara. Krijimi i mekanizmave financiarë do të jetë thelbësor për tejkalimin e kësaj sfide.
6. **Kapacitetet teknike dhe administrimi i projekteve:** Implementimi i një plani të tillë kërkon aftësi teknike dhe kapacitete administrative për menaxhimin e projekteve të mëdha dhe komplekse. Trajnimi i personelit të administratës dhe i profesionistëve të sektorit privat është një domosdoshmëri.
7. **Ndërgjegjësimi i publikut:** Për të maksimizuar efektivitetin e masave, është e nevojshme që publiku të jetë i informuar për përfitimet e rinovimeve dhe të inkurajohet të marrë pjesë aktive në zbatimin e tyre.

Efektet e Pritshme:

1. **Ndikimet ekonomike:** Reduktimi i kostove të energjisë për konsumatorët, përmirësimi i bilancit energjetik kombëtar dhe nxitja e ekonomisë së gjelbër do të ndikojnë pozitivisht në qëndrueshmërinë ekonomike afatgjatë.

2. **Ndikimet mjedisore:** Ulja e konsumit të energjisë dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme do të kontribuojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit dhe mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht në zonat urbane të ngarkuara, si dhe do të ndikojë në uljen e emetimeve të gazeve me efekt serra.
3. **Ndikimet sociale:** Ndihma për familjet vulnerabël nëpërmjet përmirësimit të kushteve të banimit do të ndihmojë në reduktimin e varfërisë energjetike dhe do të përmirësojë mirëqenien sociale.
4. **Forcimi i infrastrukturës dhe rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike:** Ndërtesat e rinovuara do të jenë më të qëndrueshme ndaj fenomeneve ekstreme klimatike dhe do të kontribuojnë në ndërtimin e një infrastrukture më të sigurt dhe afatgjatë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Këshillit të Ministrave. Plani është hartuar në përputhje me objektivat dhe udhëzimet e Planit të Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

V. VLERËSIMI I SHKALLES SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNITAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me Acquis Communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT VENDIMIT

Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet se, miratimi i Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Në pikën e dytë të projektvendimit përcaktohet se, Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave rishikohet çdo 5 (pesë) vjet.

Në pikën e tretë të projektvendimit përcaktohet se, duke filluar nga data 25 mars 2025 e në vijim, çdo 2 (dy) vjet, ministria përgjegjëse për energjinë të përgatisë një raport për statusin e zbatimit të Planit Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave, si pjesë përbërëse e raport progresit të integruar të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

Në pikën e fundit përcaktohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

Plani Aftagjatë për Rinovimin e Stokut të Ndërtesave, në përputhje me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes së stokut të ndërtesave dhe përcakton objektiva, masa, burime financiare dhe tregues për transformimin e tyre në ndërtesa me efikasitet të lartë energjetik dhe pa emetime deri në vitin 2050, në funksion të:

- dekarbonizimit të stokut të ndërtesave deri në vitin 2050;
- uljes së konsumit të energjisë;
- përmirësimit të kushteve të jetesës dhe komfortit në ambientin e brendshëm;
- mbrojtjes së shtresave vulnerabël përmes reduktimit të varfërisë energjetike.

Gjithashtu, synon të përmirësojë efijencën e energjisë dhe të reduktojë konsumimin e energjisë në ndërtesat e banimit, ato publike dhe të shërbimeve. Ky projekt-vendim ka për qëllim dekarbonizimin e stokut të ndërtesave, duke reduktuar ndjeshëm emetimet e gazeve me efekt serrë dhe duke kontribuar në arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit.

Në këtë kontekst, projekt-vendimi përfshin

- a) Një vlerësim të konsumit aktual të energjisë dhe projeksione për ndërtesat rezidenciale, publike dhe komerciale deri në vitin 2050;
- b) Identifikimin e masave kostoe-efektive për rinovim sipas tipologjisë së ndërtesës dhe zonës klimatike;
- c) Politika dhe masa fiskale, financiare dhe rregullatore për të nxitur rinovimet në shkallë të gjerë;
- ç) Mekanizma për monitorimin, raportimin dhe verifikimin (MRV) të kursimeve të arritura nga masat;
- d) Vlerësimin e potencialit për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë për vetëkonsum në ndërtesa;
- dh) Prezantimin e standardeve minimale të performancës energjetike, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 37/2025 dhe direktivave të BE-së;

e) Trajektoren e rinovimeve, duke përcaktuar ritmin dhe llojet e ndërhyrjeve që do të realizohen në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Pritshmëritë nga Zbatimi i Projekt-Vendimit: Zbatimi i këtij projekt-vendimi pritet të sjellë përfitime të konsiderueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale. Në aspektin ekonomik, ai do të çojë në uljen e faturave të energjisë, rritjen e punësimit dhe stimulimin e sektorit të ndërtimit dhe teknologjive të gjelbra. Në aspektin mjedisor, do të ndikojë në reduktimin e emetimeve të CO₂ dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ndërsa në aspektin social, do të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, zbutjen e varfërisë energjetike dhe rritjen e aksesit në ndërtesa më cilësore, më të sigurta dhe më të qëndrueshme.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKT VENDIMIT

Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficencën e Energjisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT VENDIMIT

Projektvendimi është përgatitur nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare për rinovimet që do kryhen, do përballohen nga buxheti i shtetit për institucionet e qeverisjes qëndrore. Institucionet e qeverisjes vendore, në varësi të situatës mund të kërkojnë mbështetje financiare nga qeverisja qëndrore në përputhje me parashikimet e nenit 22 të ligjit 139/2015. Në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare për rinovimin e ndërtesave private, Këshilli i Ministrave do të hartojë vendimin për skemën e mbështetjes financiare me qëllim rinovimin e stokut të ndërtesave të banimit.

